



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Ministri**

5634  
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 06.09/2010

**U D H Ë Z I M** Nr. 27  
**P Ë R** dt. 06.09.2010  
**VLERËSIMIN NË ARSIMIN PROFESIONAL**

Në zbatim të Ligjit Nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar" të ndryshuar

**U D H Ë Z O J**

Gjatë vitit mësimor 2010-2011 e në vazhdim do të përdoret ky sistem vlerësimi:

**I. SHKOLLAT PROFESIONALE:**

**a. Kurrikula e kulturës së përgjithshme**

Rregullorja e Vlerësimit të Nxënësve të Gjinnazit zbatohet në kurrikulën e kulturës së përgjithshme të shkollave profesionale me këtë mënyrë:

- a. Nota vjetore e një lënde llogaritet duke pasur parasysh të gjitha notat që nxënësi ka marrë gjatë vitit shkollor në atë lëndë.
- b. nota vjetore e një lënde llogaritet e ponderuar sipas tri lloj notash:
  - i. për vlerësimet ditore,
  - ii. për detyrat me shkrim të kapitujve,
  - iii. për projektet kurrikulare.
- c. Pesha e secilit lloj është e njëjtë me atë që tregohet në Rregulloren e Vlerësimit të Nxënësve të Gjinnazit.
- d. Kreditet për një lëndë llogariten si në Rregulloren e Vlerësimit të Nxënësve të Gjinnazit.
- e. Afërsisht për 18 orë mësimore zhvillohet një detyrë me shkrim i kapitujve.

## **b. Kurrikula e arsimit profesional**

Kurrikula e arsimit profesional zbatohet si më poshtë:

- i. Nota vjetore e një lënde ose moduli llogaritet duke pasur parasysh të gjitha notat që nxënësi ka marrë gjatë vitit shkollor në atë lëndë ose modul.
- ii. Kreditet për një lëndë ose modul llogariten si në Rregulloren e Vlerësimit të Nxënësve të Gjinnazit.
- iii. Pikët në arsimin profesional do të llogariten sipas formulës:  
 $Pi = \text{Vlerësimi} \times \text{nr i krediteve}$

**II.** Ngarkohet për zbatimin e këtij Udhëzimi Zëvendësministri i Arsimit Parauniversitar, Sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore

**Myqerem TAJAJ**

**MINISTËR**

